

VENDIM
Nr.1079, datë 10.12.2010

**PËR KALIMIN E OBJEKTIT “ISH-KOMBINATI I TEKSTILEVE”, BERAT, ME
NUMËR PASURIE 19/95, NË ZONËN KADASTRALE 8501, ME SIPËRFAQE 8117 M²,
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.226, DATË
23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË DREJTORISË
SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e objektit “Ish-kombinati i tekstileve”, Berat, me numër pasurie 19/95, në zonën kadastrale 8501, në qytetin e Beratit, me sipërfaqe 8117 (tetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) m², aktualisht në pronësi të “Tekstil, Berat” sh.a., në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.

2. Prona sipas pikës 1 të këtij vendimi, të shtohet në listën e inventarit të pronave, në administrim të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, miratuar me vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha